



GAZETA ZYRTARE

E REPUBLIKËS SOCIALISTE FEDERATIVE TË JUGOSLLAVISË

„GAZETA ZYRTARE E RSFJ“ botohet në gjuhën serbokroate respektivisht kroat-serbe, sllovene, maqedone, shqipe dhe hungareze. Xhiro ligjaria pranë Shërbimit Kontabël Shoqëror 60802-603-19644

E premte, 8 shkurt 1980

BEOGRAD

NUMRI 6

VITI XXXVI

Cmimi i këtij numri është 12 dinarë. — Parapagimi për vitin 1980 është 800 dinarë. Afati i reklamimit është 15 ditë. — Redaksia: Rruga Jovan Ristić Nr. 1 Fahu postar 226 — Telefoni: centrali 650-155; Redaksia 651-885; Shërbimi i parapagimeve 651-732; Teleks 11756

88.

Në mbështetje të nenit 337 pika 1 të Kushtetutës së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë nxjerri këtë

DEKRET

MBI SHPALLJEN E LIGJIT MBI MARRËDHËNIET THEMELORE JURIDIKE-PRONËSORE

Shpallet Ligji mbi marrëdhëniet themelore juridike-pronësore, aprovuar nga Kuvendi i RSFJ, në seancën e Dhomës Federative datë 30 janar 1980.

PR. Nr. 827

Beograd, më 30 janar 1980

Me autorizimin
e Kryetarit të Republikës,
nënkryetari
i Kryesisë së RSFJ,
Lazar Kolishevski, d. v.

Kryetari
i Kuvendit të RSFJ,
Dragoslav Marković, d. v.

LIGJ

MBI MARRËDHËNIET THEMELORE JURIDIKE-PRONËSORE

Kreu I

PARIMET THEMELORE

Neni 1

Qytetarët, shoqatat e qytetarëve dhe personat e tjerë juridikë civilë mund të jenë bartës të së drejtës së pronësisë në kufijtë dhe në kushtet e caktuara me ligj.

Neni 2

E drejta e pronësisë mund të ekzistojë mbi sendet e luajtshme dhe të paluajtshme.

E drejta e pronësisë nuk mund të ekzistojë mbi sendet që mund të jenë vetëm në pronësinë shoqërore.

Neni 3

Pronari ka të drejtë që sendin e vet ta mbajë, ta shfrytëzojë dhe ta disponojë në kufijtë e caktuara me ligj.

Secili ka për detyrë të përmbahet nga shkelja e së drejtës së pronësisë të personit tjetër.

Neni 4

Pronari realizon të drejtën e pronësisë në pajtim me natyrën dhe destinimin e sendit, si dhe në pajtim me interesin shoqëror të caktuar me ligj.

Ndaloheq ushtrimi i së drejtës së pronësisë në kundërshtim me qëllimin për të cilin është vendosur ose njohur me ligj, ose në kundërshtim me moralin e shoqërisë vetëqeverisëse socialiste.

Neni 5

Pronari i pasurisë së paluajtshme ka për detyrë që, me rastin e shfrytëzimit të pasurisë së paluajtshme, të përmbahet nga veprimet dhe t'i mënjanojë shkaqet që rrjedhin nga pasuria e tij e paluajtshme, me të cilat vështirësohet shfrytëzimi i pasurive të tjera të paluajtshme (përhapja e tymit, erërave të pakëndshme, ngrohtësisë, blazës, dridhjeve, zhurmës, rrjedhjes së ujërave reziduale e të tjera) përtej, masës që është e zakonshme duke marrë parasysh natyrën dhe destinimin e pasurisë së paluajtshme dhe rrethanat e vendit, ose me të cilat shkaktohet dëm i madh.

Pa ndonjë bazë të veçantë juridike ndaloheq bërja e pengesave nga paragrafi 1 i këtij neni me anë të instalimeve të posaçme.

Neni 6

Mbi sendin për të cilin ekziston e drejta e pronësisë mund të vendoset e drejta e servitutit, e drejta e barrës reale dhe e drejta e pengut, në kushtet e caktuara me ligj.

Ndaloheq ushtrimi i të drejtave nga paragrafi 1 i këtij neni në kundërshtim me qëllimin e për të cilin janë vendosur ose njohur me ligj, ose në kundërshtim me moralin e shoqërisë vetëqeverisëse socialiste.

Neni 7

Fitimi, mbrojtja dhe pushimi i së drejtës së pronësisë, i së drejtës së servitutit, i së drejtës së barrës reale dhe i së drejtës së pengut rregullohen me ligj.

Neni 8

E drejta e pronësisë mund të merret ose të kufizohet vetëm në kushtet e përcaktuara me ligj në pajtim me kushtetutën.

Kreu II

E DREJTA E PRONËSISË

1. Bartësit dhe objekti i së drejtës së pronësisë

Neni 9

Qytetari mund të ketë të drejtën e pronësisë mbi sendet që shërbejnë për plotësimin e nevojave dhe interesave të tij personale, si dhe të nevojave dhe interesave personale të anëtarëve të familjes së tij.

Qytetari, në kufijtë e caktuar me ligj, mund të ketë të drejtën e pronësisë mbi ndërtesën familjare

të banimit, ndërtesën për pushim ose këndellje dhe banesën si pjesë të veçantë të ndërtesës për plotësimin e nevojave personale dhe familjare.

Qytetari mund t'i shfrytëzojë sendet nga paragrafi 1 dhe 2 të këtij neni për të realizuar të ardhura vetëm në kushtet dhe në mënyrën e caktuar me ligj.

Neni 10

Qytetari, në kufijtë e caktuar me ligj, mund të ketë të drejtën e pronësisë mbi tokën bujqësore dhe tokën tjetër, pyjet dhe tokën pyjore, ndërtesat afariste dhe lokalet afariste, si dhe mbi mjetet e punës që shërbejnë për ushtrimin e pavarur të veprimtarive me punë personale për të realizuar të ardhura.

Neni 11

Shoqata e qytetarëve dhe personi tjetër juridik civil mund të ketë të drejtën e pronësisë mbi sendet e luajtshme që shërbejnë për realizimin e interesave të përbashkëta të anëtarëve të tyre dhe të qëllimeve për të cilat janë themeluar.

Bartësit e së drejtës së pronësisë nga paragrafi 1 i këtij neni mund të kenë të drejtën e pronësisë mbi ndërtesat afariste dhe lokalet afariste që shërbejnë për realizimin e interesave të përbashkëta të anëtarëve të tyre dhe të qëllimeve për të cilat janë themeluar, si dhe mbi ndërtesat e banimit dhe banesat si pjesë të veçanta të ndërtesave, që shërbejnë për plotësimin e nevojave të banimit të punëtorëve që punojnë në to.

Bartësit e së drejtës së pronësisë nga paragrafi 1 i këtij neni mund të kenë, në kufijtë e caktuar me ligj, të drejtën e pronësisë edhe mbi tokën që shërben për realizimin e interesave të përbashkëta të anëtarëve të tyre dhe të qëllimeve për të cilat janë themeluar.

Neni 12

Kur ndërtesa mbi të cilën ekziston e drejta e pronësisë është ndërtuar, në pajtim me ligjin, në tokën në pronësinë shoqërore, pronari i ndërtesës ka të drejtën e shfrytëzimit të tokës në të cilën është ngritur ndërtesa dhe të tokës që shërben për përdorimin e rregullt të kësaj ndërtese derisa ajo të ekzistojë.

E drejta e shfrytëzimit nga paragrafi 1 i këtij neni mund të bartet vetëm me bartjen e së drejtës së pronësisë mbi ndërtesën.

Neni 13

Disa persona kanë të drejtën e bashkëpronësisë mbi sendin e papjesëtuar, kur pjesa e secilit prej tyre është caktuar në përpjesëtim me madhësinë (pjesa ideale).

Në qoftë se pjesët e bashkëpronarëve nuk janë caktuar, supozohet se janë të barabarta.

Neni 14

Bashkëpronari ka të drejtë që sendin ta mbajë dhe ta shfrytëzojë bashkë me bashkëpronarët e tjerë në përpjestim me pjesën e vet, duke mos cenuar të drejtat e bashkëpronarëve të tjerë.

Bashkëpronari mund të disponojë pjesën e vet pa pëlqimin e bashkëpronarëve të tjerë.

Në rast të shitjes së pjesës së bashkëpronarit mbi të cilën ekziston e drejta e pronësisë, bashkëpronarët e tjerë kanë të drejtën e parablerjes, vetëm nëse kjo është caktuar me ligj.

Neni 15

Bashkëpronarët kanë të drejtë të drejtojnë bashkarisht sendin.

Për ndërmarrjen e punëve të drejtimit të rregullt të sendit nevojitet pëlqimi i bashkëpronarëve pjesët e të cilëve së bashku përbëjnë më shumë se gjysmën e vlerës së sendit.

Në qoftë se në rastet nga paragrafi 2 i këtij neni nuk arrihet pëlqimi, e ndërmarrja e punës është e domosdoshme për mirëmbajtjen e rregullt të sendit, mbi këtë vendos gjykata.

Për ndërmarrjen e punëve që i kalojnë suazat e drejtimit të rregullt (tjetërsimi i tërë sendit, ndërrimi i destinimit të sendit, dhënia e tërë sendit me qira, vendosja e hipotekës mbi tërë sendin, vendosja e servituteve reale, meremetimet e mëdha etj.), nevojitet pëlqimi i të gjithë bashkëpronarëve.

Bashkëpronarët mund t'ia besojnë drejtimin e sendit njërit ose disa bashkëpronarëve ose personit të tretë.

Shpenzimet e shfrytëzimit, të drejtimit e të mirëmbajtjes së sendit dhe barrët e tjera që kanë të bëjnë me tërë sendin i heqin bashkëpronarët në përpjesëtim me madhësinë e pjesëve të tyre.

Neni 16

Bashkëpronari ka të drejtë të kërkojë në çdo kohë pjesëtimin e sendit, përveç në kohën kur ky pjesëtim do të ishte në dëm të bashkëpronarëve të tjerë, po që se me ligj nuk është caktuar ndryshe.

E drejta nga paragrafi 1 i këtij neni nuk parashkruhet.

E pavlefshme është kontrata me të cilën bashkëpronari heq dorë përgjithmonë nga e drejta e pjesëtimin të sendit.

Bashkëpronarët caktojnë me marrëveshje mënyrën e pjesëtimin të sendit, e në rast se nuk mund të arrihet marrëveshja, vendos gjykata.

Gjykata do të vendosë që pjesëtimi të bëhet me shitjen e sendit, po që se pjesëtimi fizik është i pamundshëm ose është i mundshëm vetëm me një zvogëlim të konsiderueshëm të vlerës së sendit.

Bashkëpronarit të cilit me pjesëtim i ka takuar sendi ose një pjesë e sendit, bashkëpronarët e tjerë i garantojnë për të metat juridike dhe fizike të sendit në kufijtë e vlerës së pjesëve të veta si bashkëpronarë.

E drejta nga paragrafi 6 i këtij neni shuhet me kalimin e kohës prej tre vjetësh pas pjesëtimin të sendit.

Neni 17

Në rastet dhe në kushtet e caktuara me ligj bashkëpronësia ekziston edhe mbi sendin e papjesëtuar, pjesa e të cilit është në pronësinë shoqërore, kurse mbi pjesën ekziston e drejta e pronësisë.

Neni 18

Në rastet dhe në kushtet e caktuar me ligj mund të ekzistojë e drejta e pronësisë së përbashkët.

Pronësia e përbashkët është pronësi e disa personave mbi sendin e papjesëtuar kur pjesët e tyre janë të caktueshme, por nuk janë caktuar që më parë.

Neni 19

Në rastet dhe në kushtet e caktuara me ligj mund të ekzistojë e drejta e pronësisë mbi banesën dhe lokalet afarist si pjesë të veçantë të ndërtesës.

2. Fitimi i së drejtës së pronësisë

Neni 20

E drejta e pronësisë fitohet sipas vetë ligjit, në bazë të veprimin juridik dhe me trashëgim.

E drejta e pronësisë fitohet edhe në bazë të vendimit të organit shtetëror në kushtet dhe në mënyrën e caktuar me ligj.

Neni 21

Sipas vetë ligjit e drejta e pronësisë fitohet me krijimin e sendit të ri, me bashkim, me përzjerje me ndërtim në tokën e huaj, me ndarjen e fryteve, me parashkrim fitues, me fitim të pronësisë nga jo-pronari, me okupim dhe në raste të tjera të caktuara me ligj.

Neni 22

Personi që me material të vet, me punë personale punon një send të ri, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send.

E drejta e pronësisë mbi sendin e ri i takon pronarit nga materiali i të cilit këtë send, në bazë të veprimit juridik, e ka punuar personi tjetër.

Në qoftë se ndokush nga materiali i huaj me punën e vet ka punuar një send të ri, ai i takon atij po qe se është me mirëbesim dhe nëse vlera e punës është më e madhe se vlera e materialit, e nëse vlerat janë të barabarta, lind bashkëpronësia.

Neni 23

Kur sendet që u takojnë pronarëve të ndryshëm janë të bashkuara ose të përziera asisoj sa që nuk mund të ndahen më pa dëm të konsiderueshëm ose pa shpenzime të mëdha, mbi sendin e ri lind e drejta e bashkëpronësisë në dobi, të pronarëve të gjeratëherëshëm, në përpjesëtim me vlerën që e kanë pasur sendet e caktuara në momentin e bashkimit ose të përzjerjes.

Në qoftë se ndonjë nga pronarët ka qenë me keqbesim, pronari me mirëbesim mund të kërkojë, brenda afatit prej një viti nga dita e bashkimit ose e përzjerjes së sendeve, që i tërë sendi t'i takojë në pronësi ose që i tërë sendi t'i takojë pronarit me keqbesim dhe që ky t'ia kompensojë vlerën e sendit të tij.

Në qoftë se nga dy sende të bashkuara ose të përziera njëri ka vlerë më të vogël në krahasim me tjetrin, pronari i sendit tjetër fiton të drejtën e pronësisë mbi sendin e ri me obligim që personit që me këtë ka humbur të drejtën e pronësisë mbi sendin t'ia kompensojë vlerën e tij.

Neni 24

Personi që mund të jetë bartës i së drejtës së pronësisë, e që ndërton ndërtesën ose godinën tjetër (objektin ndërtimor) në tokën mbi të cilën tjetri ka të drejtën e pronësisë (ndërtuesi), fiton të drejtën e pronësisë edhe mbi tokën në të cilën është ndërtuar objekti ndërtimor, si dhe mbi tokën që është e domosdoshme për përdorimin e rregullt të këtij objekti ndërtimor, po qe se nuk ka ditur as që ka mundur të dinte se po ndërton në tokën e huaj, kurse pronari i tokës ka pasur dijeni për ndërtimin dhe nuk ka kundërshtuar menjëherë.

Në rastin nga paragrafi 1 i këtij neni pronari i tokës ka të drejtë që brenda tre vjetësh nga dita që ka mësuar për ndërtimin e përfunduar, por jo më vonë se dhjetë vjet pas ndërtimit të përfunduar, të kërkojë që ndërtuesi t'ia kompensojë vlerën e tokës në lartësinë e çmimit të qarkullimit, në kohën kur është marrë vendimi gjyqësor.

Neni 25

Në qoftë se ndërtuesi ka ditur se po ndërton në tokën e huaj apo nëse këtë nuk e ka ditur, kurse pronari këtë menjëherë e ka kundërshtuar, pronari i tokës mund të kërkojë që t'i takojë e drejta e pronësisë mbi objektin ndërtimor ose që ndërtuesi të rrëzojë objektin ndërtimor dhe t'ia kthejë tokën në gjendjen e mëparshme ose që ndërtuesi t'ia paguajë tokën sipas çmimit të qarkullimit.

Përjashtimisht nga dispozita e paragrafit 1 të këtij neni gjykata mund të vendosë që objekti i ndërtuar ndërtimor të mos rrëzohet po që se rezimi i

objektit ndërtimor, duke i pasur parasysh rrethanat e rastit, e veçanërisht vlerën e objektit, gjendjen pasurore të pronarit të tokës dhe të ndërtuesit, si dhe sjelljen e tyre gjatë ndërtimit, nuk do të ishte shqërsisht i arsyeshëm.

Në rastet nga paragrafi 1 i këtij neni pronari i tokës ka të drejtë edhe për kompensimin e dëmit.

Në qoftë se pronari i tokës kërkon që t'i takojë e drejta e pronësisë mbi objektin ndërtimor, ka për detyrë t'ia kompensojë ndërtuesit vlerën e objektit në lartësinë e çmimit mesatar të ndërtimit të objektit në vendin ku ndodhet, e në kohën kur është marrë vendimi gjyqësor.

Të drejtën e zgjedhjes nga paragrafi 1 i këtij neni pronari i tokës mund ta realizojë më së largu brenda afatit prej tre vjetësh nga dita e përfundimit të ndërtimit të objektit ndërtimor. Pas kalimit të këtij afati pronari mund të kërkojë kompensimin e çmimit të qarkullimit të tokës.

Neni 26

Në qoftë se ndërtuesi është me mirëbesim, kurse pronari i tokës nuk ka ditur për ndërtimin, në rastin kur objekti ndërtimor vlen shumë më tepër se toka, objekti ndërtimor bashkë me tokën i takojnë ndërtuesit, kurse ky pronarit të tokës i ka borxh kompensimin sipas çmimit të qarkullimit të tokës.

Në qoftë se vlera e tokës është shumë më e madhe, gjykata me kërkesën e pronarit të tokës objektin ndërtimor do t'ia caktojë me vendim atij dhe do ta obligojë që ndërtuesi t'ia kompensojë vlerën e ndërtimit të objektit në lartësinë e çmimit mesatar të ndërtimit të objektit në vendin ku gjendet. Këtë kërkesë pronari mund ta paraqesë brenda afatit prej tre vjetësh nga dita e përfundimit të ndërtimit të objektit ndërtimor.

Në qoftë se ndërtuesi është me mirëbesim, kurse pronari i tokës nuk ka ditur për ndërtimin, në rastin kur vlera e objektit ndërtimor dhe e tokës është përafërsisht e barabartë, gjykata objektin ndërtimor, respektivisht objektin ndërtimor dhe tokën do t'ia caktojë me vendim pronarit të tokës ose ndërtuesit, duke pasur kujdes për nevojat e tyre, e sidomos për kushtet e banimit të tyre.

Pronarit të tokës, respektivisht ndërtuesit i takon kompensimi për tokën, respektivisht objektin ndërtimor sipas dispozitës së paragrafit 1 të këtij neni.

Neni 27

E drejta e pronësisë mbi frytet që i jep sendi i takon pronarit të sendit.

Mbajtësi me mirëbesim, uzufuktuesi dhe qiramarrësi i sendit që i jep fryte fiton të drejtën e pronësisë mbi frytet në momentin e ndarjes së tyre.

Frytet nga paragrafi 2 i këtij neni, deri me ndarjen e tyre, janë pjesë përbërëse e sendit dhe i takojnë pronarit të tij.

Neni 28

Mbajtësi me mirëbesim dhe i ligjshëm i sendit të luajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues me kalimin e kohës prej tre vjetësh.

Mbajtësi me mirëbesim dhe i ligjshëm i sendit të paluajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues me kalimin e kohës prej dhjetë vjetësh.

Mbajtësi me mirëbesim i sendit të luajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues me kalimin e kohës prej dhjetë vjetësh.

Mbajtësi me mirëbesim i sendit të paluajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues me kalimin e kohës prej 20 vjetësh.

Trashëgimtari bëhet mbajtës me mirëbesim nga momenti i hapjes së trashëgimisë edhe në rastin kur trashëgimlënësi ka qenë mbajtës me keqbesim, e trashëgimtari këtë nuk e ka ditur as që ka mundur ta dinte, kurse koha për parashkrimin fitues fillon të ecë nga momenti i hapjes së trashëgimisë.

Neni 29

Mbi sendin në pronësinë shoqërore e drejta e pronësisë nuk mund të fitohet me parashkrimin fitues.

Neni 30

Koha e nevojshme për parashkrimin fitues fillon të ecë nga ajo ditë kur mbajtësi ka marrë në posedim sendin dhe mbaron me kalimin e ditës së fundit të kohës së nevojshme për parashkrimin fitues.

Në kohën e nevojshme për parashkrimin fitues llogaritet edhe koha për të cilën paraardhësit e mbajtësit të tanishëm kanë mbajtur sendin si mbajtës me mirëbesim dhe të ligjshëm, respektivisht si mbajtës me mirëbesim.

Sa i përket ndërprerjes, respektivisht, ngecjes së parashkrimit fitues aplikohen me analogji dispozitat mbi ndërprerjen, respektivisht ngecjen e parashkrimit të kërkesës.

Neni 31

Personi me mirëbesim fiton të drejtën e pronësisë mbi sendin e luajshëm që e ka marrë me shpërbllim nga jopronari, i cili në kuadër të veprimtarisë së tij vën në qarkullim sende të këtilla, nga jopronari të cilit pronari ia ka dorëzuar sendin në posedim në bazë të veprimit juridik që nuk është bazë për të fituar të drejtën e pronësisë, si dhe me anë të shitjes publike.

Pronari i mëparshëm mund të kërkojë nga fituesi me mirëbesim që t'ia kthejë sendin me shpërbllim sipas çmimit të qarkullimit, po qe se ky send ka rëndësi të veçantë për të.

Kërkesa nga paragrafi 2 i këtij neni nuk mund të paraqitet pas kalimit të afatit prej një viti nga fitimi i së drejtës së pronësisë mbi këtë send.

Neni 32

Mbi sendin e luajshëm, të cilin pronari i tij e ka braktisur, të drejtën e pronësisë e fiton personi që këtë send e ka marrë në posedim me qëllim që ta përvetësojë (okupim), po qe se me ligj nuk është caktuar ndryshe.

Mbi pasurinë e paluajshme nuk mund të fitohet e drejta e pronësisë me okupim.

Neni 33

Në bazë të veprimit juridik e drejta e pronësisë mbi pasurinë e paluajshme fitohet me regjistrimin në librin publik ose në mënyrën tjetër përkatëse të caktuar me ligj.

Neni 34

Në bazë të veprimit juridik e drejta e pronësisë mbi sendin e luajshëm fitohet me dorëzimin e këtij sendi në posedim të fituesit.

Dorëzimi i sendit të luajshëm konsiderohet i kryer edhe me dorëzimin e dokumentit në bazë të të cilit fituesi mund të disponojë këtë send, si dhe me dorëzimin e ndonjë pjese të sendit ose me veçimin apo shënimin tjetër të sendit që do të thotë dorëzim i sendit.

Kur një send i luajshëm gjendet në posedim të fituesit sipas ndonjë baze juridike, ai fiton të drejtën e pronësisë mbi të në momentin e lidhjes së veprimit juridik me pronarin e sendit në bazë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë.

Në qoftë se fituesi i së drejtës së pronësisë mbi sendin e luajshëm e lë këtë send edhe më tutje në posedim të kaluesit sipas ndonjë baze tjetër, ai fiton të drejtën e pronësisë mbi të në momentin e lidhjes

së veprimit juridik me pronarin e sendit në bazë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë.

E drejta e pronësisë mbi sendin e luajshëm që e mban personi i tretë kalon në fituesin në momentin e lidhjes së veprimit juridik me të cilin kaluesi ia ka bartur të drejtën që të kërkojë kthimin e këtij sendi. Personi i tretë ka të drejtë që ndaj pronarit të ri t'i bëjë të gjitha prapësimet që i ka pasur ndaj pronarit të mëparshëm.

Dorëzimi i sendit të luajshëm konsiderohet i kryer edhe atëherë kur nga rrethanat konkrete rezulton se është bërë dorëzimi i sendit.

Neni 35

Kur disa persona kanë lidhur veprime të veçanta juridike për të fituar të drejtën e pronësisë mbi të njëjtin send të luajshëm, që është caktuar në mënyrë individuale, këtë të drejtë e fiton personi të cilit së pari i është dorëzuar sendi.

Neni 36

E drejta e pronësisë mbi sendin fitohet me anë të trashëgimit në momentin e hapjes së trashëgimisë në pasurinë e të vdekurit, po qe se me ligj nuk është caktuar ndryshe.

3. Mbrojtja e së drejtës së pronësisë

Neni 37

Pronari mund të kërkojë me padi nga mbajtësi kthimin e sendit të caktuar në mënyrë individuale.

Pronari duhet të provojë se mbi sendin kthimin e të cilit e kërkon ka të drejtën e pronësisë dhe se sendi gjendet nën zotrimin faktik të të paditurit.

E drejta e paraqitjes së padisë nga paragrafi 1 i këtij neni nuk parashkruhet.

Neni 38

Mbajtësi me mirëbesim ia dorëzon sendin pronarit me frytet që ende nuk janë vjelë.

Mbajtësi me mirëbesim nuk është i detyruar të paguajë shpërbllimin për shfrytëzimin e sendit as që përgjigjet për keqësimin dhe shkatërrimin e sendit që janë shkaktuar gjatë kohës së mbajtjes së tij me mirëbesim.

Mbajtësi me mirëbesim ka të drejtë për kompensimin e shpenzimeve të domosdoshme të mirëmbajtjes së sendit.

Mbajtësi me mirëbesim mund të kërkojë kompensimin e shpenzimeve të dobishme në masën në të cilën është shtuar vlera e sendit.

Shpenzimet e domosdoshme dhe të dobishme nga paragrafet 3 e 4 të këtij neni pronari i sendit është i detyruar t'ia kompensojë mbajtësit me mirëbesim në masën në të cilën këto shpenzime nuk janë përfshirë me dobitë që ka pasur ai nga sendi.

Mbajtësi me mirëbesim ka të drejtë për kompensimin e shpenzimeve që ka bërë për kënaqësi të vet ose për zbukurimin e sendit vetëm nëse vlera e sendit është shtuar. Po qe se ajo që është bërë për kënaqësi ose për zbukurimin e sendit mund të ndahet prej tij pa e dëmtuar, mbajtësi me mirëbesim ka të drejtë që këtë ta ndajë dhe ta mbajë për vetë.

Mbajtësi me mirëbesim ka të drejtë të mbajë sendin derisa t'i kompensohet shumën e shpenzimeve të domosdoshme dhe të dobishme që ka pasur lidhur me mirëmbajtjen e sendit.

Kërkesa e kompensimit të shpenzimeve të domosdoshme dhe të dobishme parashkruhet brenda tre vjetësh nga dita e dorëzimit të sendit.

Neni 39

Mbajtësi me keqbesim ka për detyrë t'ia dorëzojë pronarit të sendit të gjitha frytet.

Mbajtësi me keqbesim ka për detyrë të kompensojë vlerën e fryteve të vjela që i ka konsumuar, tjetërsuar ose asgjësuar, si dhe vlerën e fryteve që nuk i ka vjelë.

Mbajtësi me keqbesim mund të kërkojë kompensojë dëmin e shkaktuar me keqësimin ose shkatërrimin e sendit, përveç nëse ky dëm do të shkatohej edhe sikur sendi të ndodhej te pronari.

Mbajtësi me keqbesim mund të kërkojë kompensimin e shpenzimeve të domosdoshme që do t'i kishte edhe pronari sikur, sendi të ndodhej te ai.

Mbajtësi me keqbesim ka të drejtë për kompensimin e shpenzimeve të dobishme vetëm nëse janë të dobishme personalisht për pronarin.

Mbajtësi me keqbesim nuk ka të drejtë për kompensimin e shpenzimeve që ka pasur për kënaqësi të vet ose për zbukurimin e sendit, por mund të marrë sendin që e ka montuar për kënaqësi të vet ose për zbukurimin e sendit kur ai mund të ndahet pa dëmtuar sendin kryesor.

Mbajtësi me mirëbesim bëhet mbajtës me keqbesim që nga momenti kur i është dërguar padia, por pronari mund të provojë se mbajtësi me mirëbesim është bërë mbajtës me keqbesim edhe para dërgimit të padisë.

Neni 40

E drejta e pronarit që të kërkojë nga mbajtësi me keqbesim dorëzimin e fryteve të vjela dhe kompensimin e vlerës së fryteve që ka konsumuar, tjetërsuar, që nuk i ka vjelë ose që i ka asgjësuar, parashkruhet brenda tre vjetësh nga dita e dorëzimit të sendit.

Kërkesa e mbajtësit me keqbesim të sendit sa i përket kompensimit të shpenzimeve parashkruhet brenda tre vjetësh nga dita e dorëzimit të sendit.

Neni 41

Personi që ka fituar sendin e caktuar në mënyrë individuale sipas bazës juridike dhe në mënyrë të ligjshme, e nuk ka ditur dhe nuk ka mundur të dinte se nuk është bërë pronar i sendit (pronar i supozuar), ka të drejtë të kërkojë kthimin e tij edhe nga mbajtësi me mirëbesim të cili sendi gjendet pa bazë juridike ose sipas bazës më të dobët juridike.

Kur dy persona konsiderojnë se janë pronarë të supozuar të të njëjtit send, bazë më të fortë juridike ka ai person që e ka fituar sendin me ngarkim me barrë në krahasim me personin që sendin e ka fituar pa ngarkim me barrë. Në qoftë se bazat juridike të këtyre personave janë të një force, përparësi ka personi të cili gjendet sendi.

E drejta e paraqitjes së padisë nga paragrafi 1 i këtij neni nuk parashkruhet.

Neni 42

Në qoftë se personi i tretë pa bazë trazon pronarin ose pronarin e supozuar në mënyrë tjetër e jo me marrjen e sendit, pronari, respektivisht pronari i supozuar mund të kërkojë me padi që ky trazim të pushojë.

Kur me trazimin nga paragrafi 1 i këtij neni është shkaktuar dëmi, pronari ka të drejtë të kërkojë kompensimin e dëmit sipas rregullave të përgjithshme mbi kompensimin e dëmit.

E drejta e paraqitjes së padisë nga paragrafi 1 i këtij neni nuk parashkruhet.

Neni 43

Pronari, respektivisht pronari i përbashkët ka të drejtë padie për mbrojtjen e së drejtës së pronësisë mbi tërë sendin, kurse bashkëpronari ka edhe të drejtë padie për mbrojtjen e së drejtës së vet të pronësisë mbi pjesën e sendit.

4. Pushimi i së drejtës së pronësisë

Neni 44

E drejta e pronësisë pushon me kalimin e sendit në pronësinë shoqërore.

Neni 45

E drejta e pronësisë që e ka personi i caktuar mbi një send pushon kur personi tjetër fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send.

Neni 46

E drejta e pronësisë pushon me braktisjen e sendit.

Sendi konsiderohet i braktisur kur pronari i tij në mënyrë të padyshimtë shpreh vullnetin se nuk dëshiron më ta mbajë.

Sendi i paluajthshëm i braktisur kalon në pronësinë shoqërore në momentin e braktisjes së tij.

Neni 47

E drejta e pronësisë pushon me shkatërrimin e sendit.

Mbi mbeturinat e sendit të shkatërruar pronari ruan të drejtën e pronësisë.

Neni 48

E drejta e pronësisë pushon edhe në raste të tjera të caktuara me ligj.

Kreu III

E DREJTA E SERVITUTIT

Neni 49

Servituti real është e drejta e pronarit të një pasurie të paluajthshme (prona sunduese) që për nevojat e kësaj pasurie të paluajthshme të kryejë veprime të caktuara në pasurinë e paluajthshme të pronarit tjetër (prona shërbyese) ose të kërkojë nga pronari i pronës shërbyese që të përmbahet nga kryerja e veprimeve të caktuara që përndryshe do të kishte drejtë t'i kryente në pasurinë e vet të paluajthshme.

Servituti real mund të vendoset edhe për kohë të caktuar ose për stinë të caktuar të vitit.

Në qoftë se prona sunduese ose prona shërbyese është mjet shoqëror në personin juridik shoqëror, punëtorët dhe punonjësit e tjerë në këtë person juridik shoqëror kanë të drejtat, respektivisht obligimet që i kanë bartësit e të drejtave, respektivisht të obligimeve që rrjedhin nga servitutet reale, po qe se me ligj ose me kontratë nuk është caktuar ndryshe.

Neni 50

Servituti real ushtrohet ashtu që sa më pak të ngarkohet prona shërbyese.

Në qoftë se gjatë ushtrimit të servitutit real nevojitet shfrytëzimi i ndonjë instalimi ose ndërmarrja e ndonjë veprimi, shpenzimet e mirëmbajtjes së këtij instalimi dhe të ndërmarrjes së këtij veprimi i heq pronari i pronës sunduese.

Në qoftë se instalimi ose veprimi shërben edhe për interesat e pronarit të pronës shërbyese, shpenzimet e mirëmbajtjes së këtij instalimi dhe shpenzimet e ndërmarrjes së këtij veprimi i heqin, në përpjestim me dobinë që kanë, pronari i pronës sunduese dhe pronari i pronës shërbyese.

Neni 51

Servituti real vendoset me veprimin juridik, vendimin e organit shtetëror dhe me anë të parashkrimit fitues.

Neni 52

Në bazë të veprimit juridik servituti real fitohet me regjistrimin në librin publik ose në mënyrën tjetër përkatëse të caktuar me ligj.

Neni 53

Me vendimin e gjykatës mbi pjesëtimin e sendit ose me vendimin e organit tjetër shtetëror servituti real vendoset kur pronari i pronës sunduese në tërësi ose pjesërisht nuk mund të shfrytëzojë këtë pronë pa shfrytëzimin përkatës të pronës shërbyese, si dhe në raste të tjera të caktuara me ligj.

Servituti nga paragrafi 1 i këtij neni fitohet ditën që merr formën e prerë vendimi, po që se me ligj nuk është caktuar ndryshe.

Me kërkesën e pronarit të tokës shërbyese, organi kompetent shtetëror përcakton edhe kompensimin përkatës, të cillin pronari i pronës sunduese ka për detyrë t'ia paguajë pronarit të pronës shërbyese.

Neni 54

Servituti real fitohet me anë të parashkrimit fitues kur pronari i pronës sunduese ka realizuar faktikisht servitutin gjatë kohës prej 20 vjetësh, kurse pronari i pronës shërbyese këtë nuk e ka kundërshtuar.

Servituti real nuk mund të fitohet me anë të parashkrimit fitues po që se është ushtruar me keqpërdorimin e besimit të pronarit ose të mbajtësit të pronës shërbyese, me forcë, me mashtrim, apo nëse servituti është ceduar deri në revokim.

Neni 55

Servituti real mbi pasurinë e paluajtshme që është mjet shoqëror në personin juridik-shoqëror nuk mund të fitohet me anë të parashkrimit fitues.

Neni 56

Pronari i pronës sunduese mund të kërkojë që ndaj pronarit të pronës shërbyese të përcaktohet ekzistimi i servitutit real.

Në padinë nga paragrafi 1 i këtij neni aplikohen me analogji dispozitat e nenit 37 paragrafi 2 të këtij ligji.

Neni 57

Në qoftë se pronari i pronës sunduese pa bazë ndalohej ose pengohet në ushtrimin e servitutit real, ai mund të kërkojë me padi që ky ndalim ose pengim të pushojë.

Neni 58

Servituti real pushon në qoftë se pronari i pronës shërbyese kundërshton ushtrimin e tij, kurse pronari i pronës sunduese tre vjet rrjesht nuk e ka ushtruar të drejtën e vet.

Pronari i pronës shërbyese mund të kërkojë që të pushojë e drejta e servitutit real kur ai bëhet i panevojshëm për shfrytëzimin e punës sunduese ose kur nuk ekziston më arsyeja për të cilën ai është vendosur.

Servituti real pushon po që se nuk ushtrohet gjatë kohës së nevojshme për fitimin e tij me anë të parashkrimit fitues, kur i njëjti person bëhet pronar i pronës shërbyese dhe i pronës sunduese ose me shkaktërrimin e pronës sunduese, respektivisht të pronës shërbyese.

Neni 59

Në qoftë se pjesëtohet prona sunduese, servituti real mbetet në dobi të të gjitha pjesëve të saj.

Pronari i pronës shërbyese mund të kërkojë që servituti real i pronarit të ndonjë pjesë të pronës sunduese të pjesëtuar të pushojë, po që se servituti real nuk shërben për nevojat e kësaj pjesë.

Në qoftë se është pjesëtuar prona shërbyese, servituti real mbetet vetëm mbi pjesët për të cilat është ushtruar.

Neni 60

E drejta e uzufuktit, e drejta e përdorimit, e drejta e banimit, si dhe e drejta e barrës reale rregullohen me ligj.

Kreu IV

E DREJTA E PENGUT

Neni 61

E drejta e pengut mund të ekzistojë mbi sendet e luajtshme, sendet e paluajtshme dhe mbi të drejtat. E drejta e pengut lind në bazë të veprimit juridik, vendimit gjyqësor dhe ligjit.

Neni 62

Në të drejtën e pengut mbi sendet e luajtshme dhe të drejtën e pengut mbi të drejtat aplikohen dispozitat mbi pengun të përmbytura në dispozita me të cilat janë rregulluar marrëdhëniet e detyrimeve.

Neni 63

Me qëllim që të sigurohet kërkesa e caktuar, sendi i paluajtshëm mund të ngarkohet me të drejtën e pengut në dobi të kreditorit (hipoteka), i cili është i autorizuar, në mënyrën e parashikuar me ligj, që të kërkojë arkëtimin e kërkesës së vet nga vlera e kësaj pasurie të paluajtshme para kreditorëve, të cilët mbi të nuk kanë hipotekë, si dhe para kreditorëve që hipotekën mbi të e kanë fituar pas tij, pa marrë parasysh ndërrimin e pronarit të pasurisë së paluajtshme të ngarkuar.

Hipoteka ka të bëjë me tërë pasurinë e paluajtshme me frytet e saj derisa janë të pandara, si dhe me pjesët e tjera përbërëse dhe aksesore të saj.

Për sigurimin e një kërkesë mund të vendoset hipoteka mbi disa pasuri të paluajtshme (hipoteka e përbashkët).

Pasuria e paluajtshme e lënë peng në tërësi siguron kërkesën e kreditorit deri në shlyerjen e plotë të kësaj kërkesë pa marrë parasysh pjesëtimin e mëvonshëm të pasurisë së paluajtshme (pandashmëria e hipotekës).

Neni 64

Në bazë të veprimit juridik ose vendimit gjyqësor hipoteka fitohet me regjistrimin në librin publik ose në mënyrë tjetër përkatëse të caktuar me ligj.

Në bazë të ligjit hipoteka fitohet në momentin kur janë plotësuar kushtet e caktuara me ligj.

Neni 65

Kur mbi të njëjtën pasuri të paluajtshme ekzistojnë disa hipoteka, radha e hipotekave caktohet sipas momentit të lindjes së tyre, po që se me ligj nuk është caktuar ndryshe.

Neni 66

Hipoteka mund të bartet në tjetrin vetëm bashkë me bartjen e kërkesës që me këtë hipotekë është siguruar.

tjerë, po qe se njëri prej tyre ia bën të pamundshme tjetrit mënyrën e gjeratëhershme të ushtrimit të zotërimit faktik të sendit që është në posedim të tyre.

Neni 81

Pavarësisht nga kontesti për shkak të pengimit të posedimit (neni 77) mund të kërkohet mbrojtja gjyqësore e posedimit në bazë të së drejtës së posedimit.

Kreu VI

TË DREJTAT E PERSONAVE TË HUAJ

Neni 82

Personat e huaj fizikë mund të jenë bartës të së drejtës së pronësisë mbi sendet e luajtshme si edhe shtetasit e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, po qe se me ligjin federativ nuk është caktuar ndryshe.

Në territorin e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, personat e huaj fizikë, në kushtet e reciprocitetit, mund të jenë bartës të së drejtës së pronësisë mbi tokën dhe ndërtesat që i kanë fituar me anë të trashëgimit si edhe shtetasit e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, po qe se me kontratën ndërkombëtare nuk është caktuar ndryshe.

Neni 83

Shteteve të huaja për nevojat e përfaqësive të tyre diplomatike dhe konsullore, si dhe organizatave dhe agjencive të specializuara të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, me pëlqimin paraprak të organit, federativ të administratës, kompetent për punët e judikaturës mund t'u shiten ndërtesa për nevojat zyrtare, mbi të cilat ekziston e drejta e pronësisë, ose në pronësi shoqërore si dhe tokat ndërtimore mbi të cilat ekziston e drejta e pronësisë për ndërtimin e ndërtesave të këtylla.

Neni 84

Personave të huaj fizikë, në pajtim me planet urbanistike, respektivisht vendimet, mund t'u jepen me qira afatgjatë, për pushim e këndellje të kohëpaskohshme ose të përhershme dhe për plotësimin e nevojave të tjera personale të tyre dhe të anëtarëve të familjeve të tyre, vetëm ndërtesat e banimit me një banesë.

Ndërtesat e banimit mund t'i japin me qira afatgjatë në bazë të paragrafit 1 të këtij neni vetëm organizatat e punës së bashkuar dhe bashkësitë shoqërore-politike.

Qiraja afatgjatë mund të lidhet jo më pak se për pesë vjet dhe jo më shumë se për 30 vjet.

Pas kalimit të afatit të kontraktuar qiraja mund të zgjatet, por kohëzgjatja e përgjithshme e qirasë sipas kontratave të mëparshme dhe të kontratave të reja nuk mund të jetë më e gjatë se 30 vjet.

Me kërkesën e qiramarrësit do të bëhet regjistrimi i qirasë afatgjatë në librin publik ose në mënyrën tjetër përkatëse të caktuar me ligj.

Qiraja afatgjatë lidhur me të cilën është bërë regjistrimi ka efekt juridik edhe ndaj fituesit të mëvonshëm të ndërtesës së banimit.

Neni 85

Ndërtesa e banimit i jepet personit të huaj fizik me qira afatgjatë me kontratë me shkrim, në bazë të pëlqimit që më parë është marrë nga organi i caktuar me ligjin republikan, respektivisht krahinor.

Aktvendimin mbi dhënien ose mosdhënien e pëlqimit për qira organi kompetent e merr sipas vlerësimit të lirë, pa treguar shkaqet, dhe ai ka formë të prerë në procedurën administrative.

Personi i huaj fizik ndërtesën që i është dhënë me qira afatgjatë mund t'ua japë me nënqira organizatave hoteliere e turistike të vendit për kohën gjatë së cilës ai nuk e shfrytëzon, në rastet dhe nën kushtet e caktuara me ligj.

Kreu VII

E DREJTA KOMPETENTE NË RAST KONFLIKTI TË LIGJEVE REPUBLIKANE, RESPEKTIVISHT KRAHINORE

Neni 86

Sa i përket formës së veprimit juridik që ka të bëjë me marrëdhëniet juridike-pronësore mbi pasuritë e paluajtshme kompetente është e drejta e republikës, respektivisht e krahinës autonome në territorin e së cilës gjendet pasuria e paluajtshme.

Neni 87

Për të drejtat dhe obligimet nga marrëdhëniet juridike-pronësore mbi pasuritë e paluajtshme kompetente është e drejta e republikës, respektivisht e krahinës autonome në territorin e së cilës gjendet pasuria e paluajtshme.

Për të drejtat dhe obligimet nga marrëdhëniet juridike-pronësore mbi sendin e luajshëm kompetente është e drejta e republikës, respektivisht e krahinës autonome në territorin e së cilës gjendet sendi në kohën e fillimit të kontestit.

Për të drejtat dhe obligimet nga marrëdhëniet juridike-pronësore mbi sendin e luajshëm që regjistrohet në librin publik, nga momenti i regjistrimit kompetente është e drejta e republikës, respektivisht e krahinës autonome në territorin e së cilës mbahet ky libër publik.

Neni 88

Në qoftë se qytetari ka pasuri të paluajtshme në territorin e disa republikave, respektivisht të krahinave autonome, për caktimin e maksimumit të pasurive të paluajtshme mbi të cilat ekziston e drejta e pronësisë kompetente është e drejta e asaj republike, respektivisht krahine autonome që për të është më e volitshme, me kusht se në territorin e një republike respektivisht krahine autonome nuk mund të ketë më shumë nga maksimumi i pasurive të paluajtshme mbi të cilin ekziston e drejta e pronësisë të përcaktuar për atë republikë, respektivisht krahinë autonome.

Dispozita e paragrafit 1 të këtij neni aplikohet edhe ndaj shoqatave të qytetarëve dhe ndaj personave të tjerë juridikë civilë.

Kreu VIII

DISPOZITAT E FUNDIT

Neni 89

Ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji shfuqizohen dispozitat e neneve 40b, 40c, 40ç dhe të nenit 41 të Ligjit mbi qarkullimin e tokës e të ndërtesave («Gazeta Zyrtare e RSFJ», dr. 43/65, 57/65, 17/67 dhe 11/74) dhe dispozitat e neneve 439, 441, paragrafet 2 e 3, dhe të nenit 443 paragrafi 1 të Ligjit mbi procedurën kontestimore («Gazeta Zyrtare e RSFJ», nr. 4/77).

Neni 90

Ky ligj hyn në fuqi më 1 shtator 1980.

Kreditori hipotekar mund të vendosë hipotekën mbi hipotekën ekzistuese në dobi të personit të tretë pa pëlqimin e debitorit hipotekar (mbihipoteka).

Neni 67

Në qoftë se debitori hipotekar zvogëlon vlerën e pasurisë së paluajtshme të ngarkuar me hipotekë ose në mënyrë tjetër keqëson gjendjen e saj, kreditori hipotekar mund të kërkojë që gjykata të udhërojë debitorin hipotekar që të përmbahet nga veprimet e këtilla, e po qe se ai këtë nuk e bën, mund të kërkojë arkëtimin e dhunshëm të kërkesës së siguruar me hipotekë edhe para se të arrijë afati i kërkesës.

Neni 68

Pushimi i hipotekës mund të kërkohej:

- kur debitori hipotekar paguan kërkesën e siguruar me hipotekë;
- kur kreditori hipotekar heq dorë nga hipoteka me deklaratën me shkrim të dhënë para organit shtetëror kompetent që mban librin publik në të cilin është regjistruar hipoteka;
- kur pasuria e paluajtshme e ngarkuar me hipotekë ka kaluar në pronësinë shoqërore;
- kur i njëjti person është bërë bartës i së drejtës së pronësisë dhe bartës i hipotekës mbi të njëjtën pasuri të paluajtshme, dhe
- kur shkatërrohet pasuria e paluajtshme e ngarkuar me hipotekë, po qe se nuk përtërihet.

Kur pasuria e paluajtshme e ngarkuar me hipotekë kalon në pronësinë shoqërore, fituesi ka për detyrë të paguajë kërkesën e siguruar me hipotekën mbi këtë pasuri të paluajtshme deri në lartësinë e çmimit të saj të qarkullimit në momentin e kalimit në pronësinë shoqërore, po qe se për disa raste me ligj nuk është caktuar ndryshe.

Kur pronarit të pasurisë së paluajtshme të ngarkuar me hipotekë, e cila ka kaluar në pronësinë shoqërore, e është dhënë si kompensim pasuria tjetër e paluajtshme, hipoteka kalon mbi këtë pasuri të paluajtshme.

Neni 69

E pavleshme është dispozita e kontratës mbi hipotekën me të cilën kreditori hipotekar kontraktin për vete të drejtën që në rast mospagimi të borxhit të realizojnë kërkesën e vet me fitimin e së drejtës së pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme të lënë peng, me vjeljen e fryteve që i jep kjo pasuri e paluajtshme ose me shfrytëzimin e pasurisë së paluajtshme në mënyrë tjetër.

Kreu V

POSEDIMI

Neni 70

Posedimin e sendit e ka çdo person që ushtron drejtpërdrejt zotërimin faktik të sendit (posedimi i drejtpërdrejtë).

Posedimin e sendit e ka edhe personi që zotërimin faktik të sendit e ushtron nëpërmjet personit tjetër, të cilit në bazë të uzufuktit, kontratës së shfrytëzimit të banesës, qirasë, ruajtjes, huapërdorjes ose veprimit tjetër juridik ia ka dhënë sendin në posedim të drejtpërdrejtë (posedimi i tërthortë).

Posedimin e së drejtës së servitutit real e ka personi që faktikisht shfrytëzon pasurinë e paluajtshme të personit tjetër në vëllimin që i përgjigjet përmbajtjes së këtij servituti.

Disa persona mund të kenë posedimin e sendeve ose të drejtave (bashkëposedimi).

Neni 71

Personi që në bazë të marrëdhënies së punës ose të marrëdhënies së ngjashme, ose në familje, ushtron zotërimin faktik të sendit për personin tjetër, e që ka për detyrë të veprojë sipas udhëzimeve të këtij personi tjetër, nuk gëzon posedimin.

Neni 72

Posedimi është i ligjshëm po qe se mbështetet në bazën e plotfuqishme juridike që nevojitet për të fituar të drejtën e pronësisë dhe nëse nuk është fituar me forcë, me mashtrim ose me keqpërdorimin e besimit. Posedimi është me mirëbesim po qe se mbajtësi nuk di ose nuk mund të dijë se sendi që e mban nuk është i tij.

Mirëbesueshmëria e posedimit supozohet.

Neni 73

Trashëgimtari bëhet mbajtës në momentin e vdekjes së trashëgimlënës, pa marrë parasysh se kur e ka fituar zotërimin faktik të sendit.

Neni 74

Posedimi humbet kur mbajtësi pushon të ushtrojë zotërimin faktik të sendit.

Posedimi nuk humbet po qe se mbajtësi është përkohësisht i penguar të ushtrojë zotërimin faktik pavarësisht nga vullneti i tij.

Neni 75

Çdo mbajtës i sendeve dhe i të drejtave (neni 70) ka të drejtë për mbrojtje nga trazimi ose marrja e posedimit (pengimi i posedimit).

Neni 76

Mbajtësi ka të drejtë për vetëndihmë kundër atij që në mënyrë të paautorizuar e trazon në posedim ose ia ka marrë, me kusht që rreziku të jetë i drejtpërdrejtë, që vetëndihma të jetë e domosdoshme dhe që mënyra e ushtrimit të saj t'u përgjigjet rrethanave në të cilat ekziston rreziku.

Neni 77

Mbrojtja gjyqësore nga trazimi, respektivisht nga marrja e posedimit mund të kërkohej brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e njoftimit për pengimin dhe kryesin, e më së largu brenda afatit prej një viti nga dita e pengimit të bërë (kontesti për shkak të pengimit të posedimit).

Neni 78

Gjykata siguron mbrojtjen sipas gjendjes së fundit të posedimit dhe pengimit të bërë, me ç'rast nuk ka ndikimin e drejta për posedimin, baza juridike e posedimit dhe mirëbesueshmëria e mbajtësit.

Edhe mbajtësi që posedimin e ka fituar me forcë, fshehtas ose me keqpërdorimin e besimit ka të drejtë për mbrojtje, përveç ndaj personit nga i cili në mënyrë të tillë ka realizuar posedimin, po qe se nga pengimi i bërë nuk kanë kaluar afatet nga neni 77 i këtij ligji.

Neni 79

Me vendimin mbi kërkesën për mbrojtjen nga pengimi i posedimit caktohet ndalimi i trazimit të mëtejshëm të posedimit nën kërcënimin e gjobës, respektivisht kthimit të posedimit që është marrë, si dhe masat e tjera të nevojshme për mbrojtje nga pengimi i mëtejshëm.

Neni 80

Bashkëmbajtësi gëzon mbrojtjen sipas dispozitës së nenit 75 të këtij ligji ndaj personave të tretë, si dhe në marrëdhëniet reciproke me bashkëmbajtësit e